



01/Nr. 8584/2024  
Data: 23.10.2024

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e nëntë -IX- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.09.2024 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2026-2027.
3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.
4. Propozim për ndryshimin e rregullores për taksa komunale për vitin 2025.
5. Propozim për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
6. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025.
7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- më intereson materiali shtesë që e pranuar tash te drejtoria për urbanizëm kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit, kërkoj sqarim.

**Kryesuesi** thekson:- me sa munda me u informuar është material shtesë që duhet të ndryshohet për shkak se i është drejtuar prej Qeverisë drejtorit dhe pasi është plotësimit ndryshimi i rregullores për taksa komunale i plotësojmë edhe këto.

**Zaim Bela** thekson:- në material nuk na është dërguar material shtesë për shkak se ne u dakorduar për buxhetin. A keni ndonjë material shtesë për çështje të buxhetit apo është në formë siç na është përcjell më herët.

**Kryesuesi** thekson:- për çështje të materialit shtesë kur të diskutohet për çështjen e buxhetit drejtoresha do ta sqaron. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.



## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. Buxheti i komunës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2026-2027.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit është një plan fiskal që përcakton të hyrat dhe shpenzimet e parashikuara për të udhëhequr shërbimet dhe politikën që zbatohen gjatë vitit fiskal 2025. Ai përcakton bazat për ato që do të jenë qëllimet dhe arritjet e komunitetit tonë. Buxheti i propozuar do të vazhdojë të arrijë prioritetet afatmesme të komunës siç janë aprovuar në qershor 2024 me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027. Ju do të shihni se këtyre prioritetëve do t'i referohem përgjatë këtij dokumenti. Për më tepër, buxheti i propozuar reflekton kryesisht kërkesat e qytetarëve, siç paraqiten gjatë dëgjimeve publike buxhetore, të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi komunal. Buxheti i vitit 2025 pasqyron përpjekjen tonë të vazhdueshme për të ofruar shërbime arsimore cilësore në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm; shërbime shëndetësore, si dhe zhvillim të mëtutjeshëm të infrastrukturës që do të japë kontribut drejt zhvillimit të komunës së Hanit të Elezit. Për t'i zbatuar prioritetet e mësipërme, buxheti për vitin fiskal 2025 ka përfshirë gamën e plotë të operacioneve dhe programeve komunale të cilat i përfshijnë të mëposhtmet: Zyra e Kryetarit, Administrata dhe Personeli, Zyra e Kuvendit Komunal, Buxheti dhe Financat, Shërbimet Publike, Emergjencia dhe Mbrojtja Civile, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural, Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi, Planifikimi Urban dhe Inspeksioni, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, Arsimi dhe Shkenca dhe Kultura, Rinia dhe Sporti. Programet e komunës vazhdojnë ta pasqyrojnë qëllimin tonë për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve tanë/tona, shoqëruar me një menaxhim të shëndoshë dhe financiar. Ky buxhet i mundëson komunës t'i mbajë të qëndrueshme shpenzimet dhe të financojë iniciativa dhe projekte të rëndësishme ku i keni të paraqitura më poshtë në tabelën e Investimeve Kapitale Komunale 2025-2027. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2026 janë në shumë prej 3,789,234.00 € dhe për vitin 2027 janë në shumë prej 3,967,100.00 €. Për pagat dhe shtesat 2,188,542.00 € apo 60.5 %, për mallrat dhe shërbimet 584,500.00 € apo 16 %, për shpenzimet komunale 94,000.00 € apo 2.5 %, për subvencionet dhe transferet 143,000.00 € apo 4 %, për shpenzimet kapitale 605,415.00 € apo 17 %, Totali 3,615,457.00 € apo 100%. Për të hartuar buxhetin ne kemi kaluar të gjitha fazat të cilat janë të bazuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi. Janë mbajtur dëgjimet buxhetore dhe propozimet i kemi marr prej qytetarëve dhe ua kemi bashkangjitur si material shtesë me material. Takim kemi mbajtur me kryesuesin e kuvendit dhe me shefat e grupeve parlamentare me të cilët i kemi diskutuar të gjitha propozimet që janë dhënë nga ana e qytetarëve që shumica e tyre ishin veç se të përfshira në listën e projekteve kapitale, ndërsa së bashku me shefat e grupeve parlamentare vendosëm që të shtohen edhe katër projekte të reja, rregullimi i rrugës Fujza-Vërtomicë, rregullimi i rrugës prej te burime deri në Lepenc, shtrimi me zhavorr i rrugës prej te burimi i fshatit Seçishtë deri te Lloka, ndërtimi i rrjetit elektrik nëntokësorë në zonën urbane të Hanit të Elezit. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.



**Sherif Berisha** thekson:- sa i përket planifikimeve buxhetore për vitin 2025 çështja e parë që dua të diskutojë është çështja e pagesave që rrjedhin nga procedurat gjyqësore për çështjen e kontratës kolektive dhe kërkoj sqarim se a janë të planifikuara mjetet për vitin 2025 për mësimdhënësit të cilët kanë ngritur padi për shujtat dhe kualifikimet për shkak se po i bien se ju po planifikoni projekte kapitale sikur se edhe në këtë vit dhe gjitha mjetet po i marrin përmbaruesit. Për vitin 2025 ishin dy projekte të reja të planifikimet për investime kapitale, njëri te drejtoria për zhvillim ekonomikë dhe dy projekte te drejtoria për kulturë pra kjo listë ishte kopje e investimeve nga viti i kaluar sikurse ndriçimi publik nëpër fshatra i cili në vitin 2024 ka pasur të planifikuara 13 000 €, ndërsa në këtë vit janë 10 000 €, riparimi i rrugëve dhe trotuareve nga 6915 € në vitin 2024 sa ishin të planifikuara tash është 10 000 €. Ndërtimi i deponisë nga mbetjet e ngurta nga 5 000 € ndërsa në vitin 2025 është 15 000 €. Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në rrugën Isa Berisha dhe në zonat rurale për vitin 2024 nga 10 000 € në vitin 2024 kurse për vitin 2025 keni planifikuar 50 000 €, ndërtimi i mureve mbrojtëse 20 000 € në vitin 2024 ndërsa në vitin 2025 keni planifikuar 5000 €, shtrimi me kupëza betoni dhe trotuaret në Han të Elezit në vitin 2024 janë planifikuar 50 000€ ndërsa në vitin 2025 janë planifikuar 35 000 €, te shpronësimet të fabrika e ujit te oborri i Shtëpisë së Kulturës nga 65 000€ të planifikuara për vitin 2024 për vitin 2025 keni planifikuar 80 000 €, rregullimi i hapësirave publike nga 10 000 € në 12 000 €. Është shumë me rëndësi që të na njoftoni se çfarë investime po bëni në shkolla sepse në këtë vit keni pasur një investim prej 40 000 ndërsa për vitin e ardhshëm i keni planifikuar 62 000 € por është mirë që për këtë investim me vlera kaq të larta nëpër shkolla të na mbani të informuar . Sa i përket hapjes së rrugës transit unë mendojë që i keni mashtruar banorët sepse ju i keni të gjitha nënshkrimet për hapjen dhe rregullimin e kësaj rruge ndërsa në anën tjetër nuk e keni ndërmarr mundim më të vogël për ta rregulluar, kurse për vitin 2025 nuk keni planifikuar mjete financiare për të njëjtën rrugës sepse e dimë që është nevojë imediate për fshatin Gorancë. Te projekti vendosja e ekranit për prezantimin e rezultatit të ndotjes së ajrit është viti i tretë që ne si lëvizje vetëvendosje propozojmë që ky projekt të realizohet duke i ndarë mjetet buxhetore por nga ju ky projekt nuk ka fare rëndësi, te rregullimi i infrastrukturës sportive te stadiumi “Suad Brava” a është i njëjti kod me projektin e ri që është bërë që është mbështetur nga deputeti i jonë i vetëm që është z.Mirsad Shkreta e me që është investim i Ministrisë së Kulturë e ndoshta nuk është futur fare për vitin e ardhshëm. Nuk po mundem të kuptojë Kryetarë që nga postimet e juaja rruga Gorancë – Krivenik nuk ka të planifikuara mjete financiare nga komuna për vitin 2025. Propozoj që të bëhet vendosja e ekranit për prezantimin e rezultateve të ndotjes së ajrit në qendër të Hanit të Elezit , subvencioni i lehonive propozoj nga 100 € të bëhet 300 €, blerja e një kamioni për pastrimin e qytetit, të qiten mjete në hapjen e rrugës transit në fshatin Gorancë, të ketë një kod buxhetorë për stadiumin e qytetit. kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare që të më mbështesin për projektet e propozuara.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- i pash projektet e planifikuara dhe projektet të cilat i keni shtuar por unë mendoj që më e rëndësishme është shtrimi me asfalt i rrugës së Gorancës te pjesa që është e dëmtuar për shkak se ne ishim në Ministri dhe projekti ishte në procedura gjyqësore dhe besoj që ka me vazhduar gjatë dhe unë propozoj që ajo rrugë të shtrohet me asfalt përkohësisht deri sa Ministria të vazhdon me projektin.

**Ajnure Thaçi** thekson:- ku është planifikuar lokacioni për ndërtimin e çerdhes për në Lagje të Re.

**Refet Kalisi** thekson:- propozimin të cilin e kam pasur për rregullimin e nxehjes në objektin e komunës për të cilin mendojë se është prioritet.

**Zaim Bela** thekson:- projektet e reja nuk i keni dhe është dashur me najë përcjell me shkresë se ku janë shtuar dhe ku janë marr mjetet financiare kërkoj që të na ipet sqarime. E dimë që rruga e Gorancës është në kuadër të Ministrisë por atë rrugë shumë banorë po e frekuentojnë dhe është mirë që ajo pjesë që është afër 100 metra me u shtruar me asfalt.

**Erblin Meliqi** thekson:- para dy mbledhjeve kam bërë propozim që të rregullohen shkallët te varrezat e qytetit për shkak se është e nevojshme për atë pjesë të banorëve të cilët e frekuentojnë.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:-propozimin të cilin e kam parashtruar më herët për rregullimin e përroit te rruga Ismail Qemajli a është përfshirë në kodet buxhetore.



**Resul Suma** thekson:- në takimin që kemi pasur me shefat e grupeve parlamentare jemi dakoduar për ato propozimet e qytetarëve që do të hyjnë në planifikimet buxhetore drejtoresha me na i sjell këtu. Pasi t'i marrim përgjigjet nga ekzekutivi i komunës dhe para se me shkuar në votim kërkoj një pauzë prej pesë minutave që ta kemi

**Lindita Ballazhi** thekson:- nuk mundemi ne që të planifikojmë mjete financiare për kontratën kolektive pasi që ne pajtimet gjyqësore të cilat i kemi bërë me mësimdhënësit i kemi dërguar për ekzekutim në thesar por nuk janë ekzekutuar në formë të rregullt. U potencua që projekte të reja ka në zhvillim ekonomikë dhe kulturë por kjo nuk qëndron kështu me qenë se kemi të përfshirë edhe projekte të tjera. U potencuan edhe disa projekte të tjera por ato janë standarde të cilat barten vit pas viti. Projekti për vendosjen e ekranit për prezantimin e rezultateve të ajrit është i planifikuar në listën e projekteve kapitale. Projekti i vendosjes së nxehtë në objektin e komunës është i planifikuar në kuadër të listës së projekteve kapitale vendosja e nxehtë me pompë termike në institucionet publike . Projektet e reja nuk i kam bashkangjitur si material shtesë pasi që edhe pjesa tjetër e asamblesë duhet të shikohen se a janë të pajtimt që të hyjnë edhe ato projekte në listën e projekteve kapitale por megjithatë un mundem me ua siguruar por ashtu siç i keni kërkuar në atë takim ashtu janë të buxhetuara. Projekti i rregullimit të shkallëve te varrezat është i planifikuar në kuadër të listës së projekteve kapitale. Projekti i rregullimit të përroit te rruga “Ismail Qemajli” është në kuadër të listës së investimeve kapitale, projekti i stadiumit “Suad Brava” është ndryshuar në sistem.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket kontratës kolektive nuk kemi ndonjë planifikim të veçantë për shkak se kontrata kolektive është qe sa vite dhe këto që punojnë në arsim e dinë sepse ne jemi tu përballë dhe nuk është një borxh që na e kemi krijuar por jemi duke u munduar që në baza ligjore me kryer këtë borxh, rregullisht kemi grupe për me i implementuar këto borxhe. Nuk e dimë sa në këtë vit do të kryhen edhe sa do të mbesin vitin e ardhshëm. Jemi duke i implementuar disa projekte që disa janë në fazën e prokurimit dhe nuk e dimë që do të realizohen deri në fund për shkak se mund të merren mjetet prej përmbaruesit nga ndonjë projekt. Për rrugën anësore në fshatin Gorancë nuk i kam nënshkrimet nuk e di pse e potenconi që janë nënshkrimet por ne jemi duke u marr me këtë çështje. Dje kam pasur takim me KKSb-në dhe prezent ishin edhe përfaqësuesit e FSK-së dhe kam parashtruar kërkesë të batalioni i xhenios për hapjen e rrugës anësore në fshatin Gorancë që do të thotë këtë çështje e kemi parasysh. Për stadiumin “Suad Brava” sot kemi pranuar një informacion që ky projekt po kryhet në shumë prej 395 000 €. Lokacioni për ndërtimin e një çerdhe në Lagje të re është te rruga Ismail Qemali bëhet fjalë për parcelën që janë duke u grumbulluar mjetet e që gati është në përfundim dhe kur të kryhet kalon në pronë shoqërore e pastaj fillon ndërtimi i çerdhes. Shkallët te varrezat janë në projekt. Rregullimi i përroit është në projektë por e kemi diskutuar që mermes IPA fondeve me kryer. Buxheti jemi munduar me shpërndarë duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore por edhe propozimet juaj që mund ti jepni këtu por duhet të harmonizohen në shumën e buxhetit për vitin 2025.

**Refet Kalisi** thekson:- për projektin e çatisë së komunës që janë planifikuar 50 000 € kërkoj sqarim se për çka bëhet fjalë.

**Nora Xhoni** thekson:- kërkoj sqarim te çështja e shpronësimit i fabrikës së ujit, shtëpia e kulturës –oborri , stadiumi i qytetit.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- të gjitha propozimet e projekteve janë në kode buxhetore duke marr parasysh mundësitë buxhetore që i kemi është mirë që prioritet tu epet rrugëve që kanë më shumë nevojë dhe ku është përqindja më e madhe e komunitetit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çatia e komunës është e planifikuar për shkak dëmeve që janë shkaktuar prej breshrit. Sa i përket shpronësimit ne ndajmë mjete buxhetore aq sa ne parashohim por nuk e dimë shumën për shkak se janë procedurat që e përcaktojnë.



**Erblin Meliqi** thekson:- kërkoj sqarim për projektin për pajisje të ajtisë nëpër shkolla.

**Hisni Luri** thekson:- janë planifikuar 62 000 € për tabelat e mençura.

**Kryesuesi** thekson:- të gjitha propozimet i keni pranuar dhe po besojë që ashtu siç jemi dakorduar edhe më herët edhe tash dhe nëse nuk ka edhe ndonjë diskutim e hedh në votim buxhetin e komunës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2026-2027, rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër 1 abstenim.

**U MIRATUA BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2026-2027**

### **3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025**

### **4. Propozim për ndryshimin e rregullores për taksa komunale për vitin 2025.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- rregullorja ka dal në debat publik dhe para qytetarëve i kemi paraqitur propozimet për plotësim ndryshimin e kësaj rregullore. Kryesuesi i Kuvendit e elaborojë pjesë e taksave sa i përket drejtorisë së urbanizmit për shkak se me udhëzim administrative janë ndryshuar që janë taksat e kadastrit dhe gjobat mandatore.

**Sherif Berisha** thekson:- arsyeja e shtimit të vlerave që janë shtuar dhe pjesa që është hequr, a ka ndonjë arsye që është propozuar në këtë formë.

**Natyra Kalisi** thekson:- sa i përket rritjeve që kanë ndodhur te regjistrimet e më vonshme të vdekjeve ka ndodhur për një arsye për shkak se zyra e pensioneve vazhdimisht na ka përcjell informata për qytetarët të cilët nuk i kanë deklaruar vdekjet dhe afat për me i regjistruar është tridhjetë ditë dhe pas tridhjetë ditëve dhe kjo taksë edhe me udhëzim administrativ është e përcaktuar.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- vërtetimi i të mirave materiale kërkoj që të na sqaroni për çka bëhet fjalë.

**Natyra Kalisi** thekson:-është dokument që lëshohet nga gjendja civile që kërkohet nga të huajt Kosovarë të cilët jetojnë në vendet e bashkimit evropian.

**Resul Suma** thekson:- propozimi për ndërrimin e emrit dhe mbiemrit propozohet që të zvogëlohet, ndërsa në debat publik është propozuar që të rritet nga dhjetë në tridhjetë euro, cili propozim do të votohet përpara.

**Natyra Kalisi** thekson:- çështja e propozimeve është e Kuvendit se cilin do ta miratojë, mirëpo për mendimin tim është që të miratohet propozimi që është dhënë nga ekzekutivi i komunës.

**Kryesuesi** thekson:- propozimin që është dhënë nga ekzekutivi i komunës e hedh në votim, rezultati i votimit ishte një zëri. Në tërësi e hedh në votim plotësim ndryshimin e rregullores për taksa komunale për vitin 2025, rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROPOZIMI PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2025**



## 5. Propozim për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- debati publikë është mbajtur për rregullore në fjalë dhe nga debati publikë janë dhënë edhe propozimet. Propozimet që i kemi dhënë si drejtori janë konkretisht në drejtorinë e arsimit numri i bursave të rriten nga katërdhjetë në pesëdhjetë dhe harmonizimi i rregullores me rregulloret e ministrive të komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e bursave pra komisioni të jetë prej pesë anëtarëve. Në material i keni pasur edhe propozimet që janë dhënë nga debati publik . Studentët të cilët bëjnë punë vullnetare propozojë që nga tre pikë të jetë në gjashtë pikë në mënyrë që të stimulohen studentët që të bëjnë punë vullnetare për të mirën e komunitetit tonë.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- ju përgëzoj për plotësim ndryshimin e rregullores për me rritur numrin e bursistëve nga katërdhjetë në pesëdhjetë studentë.

**Kryesuesi** thekson:-propozimi që është dhënë për punë vullnetare që të jetë gjashtë pikë unë mendoj që të mbetet siç ka qenë . Propozimin e z.Akif Shkreta e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte 3 për 12 kundër. Propozim e z.Rashid Lusnjani e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte 14 kundër, 1 abstenim. Në tërësi e hedh në votim propozimin për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve ;rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U MIRATUA PROPOZIM PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE.

## 6. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Malik Berisha** thekson:- për tekstet është mirë që në vitin e ardhshëm me u dakorduar në ndonjë librari për me i siguruar në mënyrë që mos me shkuar në Ferizaj për shkak se është kosto për shumicën e familjeve.

**Hisni Luri** thekson:-nuk është që nuk kemi bërë përpjekje por siç e dini libraritë funksionojnë në mënyrë private dhe ka qenë sfidë se prindërit kanë shkuar në qytetet të tjera dhe kanë pritur rendë por përsëri nuk kanë mundur mu pajisur me libra për shkak se edhe libraritë e komunave tjera kanë përgatitur tekste sa për nxënësit e komunës së vetë.

**Nora Xhoni** thekson:-me një mbledhje prindërore kujdestarët e klasëve bënë apel te prindërit që fëmijët e tyre ti kontrollojnë dhe mos ti lejojnë me konsumuar pije energjike. Apelojë që fëmijët ti ushqejnë në mëngjes dhe tu japim ushqim me vete dhe të jemi kundër pijeve energjike.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- a ekziston mundësi që në pushim të gjatë nxënësit mos me dal jashtë shkollës.

**Hyriete Isufi** thekson:- për deri sa ne ju rrimë te dera me u a ndalë pijet energji por sa dalim i shohim prindërit të cilët blejnë pije energji që do të thotë se problemi është se duhet me u krodinuar edhe ata në shpi se ne si mësimdhënës nuk po mundemi me bërë asgjë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 7.Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- salla te Shtëpia e Kulturës a është private a është publike dhe nëse është publike kërkojë që edhe për klubet tjera drejtoria përkatëse të jep leje për me i kryer aktivitete e tyre sportive.

**Refet Kalisi** thekson:- çështja e hapjes së gropave nëpër rrugë e dimë se është e kompanisë “Bifurkacioni” por me të vërtetë janë bërë shqetësuese. Nëse kemi mjete financiare është mirë me i bërë na si institucion komunal mos me prit kompaninë “Bifuracioni”

**Erbllin Meliqi** thekson:- është mirë që të angazhohemi për me i rregulluar dritat e ndriçimit publik nëpër fshatra në ato pjesë ku janë prishur.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- salla e sporteve janë dëmtuar gjatë reshjeve të breshrit dhe jemi duke shikuar fonde për me rregulluar për shkak se nuk kemi ndonjë fond emergjentë. Nuk besojë që krijimtarinë sportive mungesa e hapësirave ka mbetur pa e zhvilluar sepse ka salla edhe tjera dhe klubi futbollistik i Volibollit po ushtron në Paldenicë apo në Gorancë. Salla e sportit të Shtëpia e Kulturës nuk është private por është publike , mirëpo nëse ka diçka që keni ju në mes shfrytëzuesve është diçka tjetër se pak a shumë e di i keni inatet por janë çështje që mund ti zgjidhni. Mbyllja e gropave po besojë që në muajin tetor do të kryhet.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- nesër fillon muaji tetor që është si muaji rozë që ka për qëllim vetëdijesimin për kancerin e gjirit dhe ju ftojë të gjithëve që të jeni pjesë aktive e të gjitha aktiviteteve që do të mbahen në muajin tetor. Për të gjitha aktivitetet që do të mbahen do të ju njoftojë me kohë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:47.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

